



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300246/1

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandime për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e shtetasve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/ Komisariatin e Policisë në Vlorë.*

Drejtuar: **Ermal MUÇAJ**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë

VLORE

Mariglen Duçi
Shef i Komisarariatit të Policisë Vlorë

VLORE

Për dijëni: **Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në mjediset e privimit të lirisë së personit, ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë në Vlorë.

Inspektimi u krye në datën 02.03.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga znj. Nertila Qafzezi, z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

U verifikuan gjithashtu kushtet dhe kriteret e ndërtimit të ambientit të shoqërimit dhe të sigurisë sipas kërkesave të parashikuara në procedurën standarde: “*Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*” miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, si dhe procedurën standarde: “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*” miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938 datë 24.07.2019.

Aspekt tjetër i inspektimit, ishte dhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dërguar institucionit më datë 15.12.2022¹

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e MKPT-së, për zhvillimin e inspektimit në mjediset e policisë së shtetit ku mbahen e trajtohen shtetasit që ju privohet liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e komisariatit z. Mariglen Duçi si dhe shefin e rendit në Komisaratin e Policisë në Vlorë, z. Kristaq Pata.

Pasi mori një informacion të përgjithshëm në lidhje me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e këtij komisariati dhe kushtet në të cilat ndodhen dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, grupi i inspektimit kërkoi një informacion në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022.

Në vijim, u inspektuan ambientet e shoqërimit dhe ato të sigurisë të komisariatit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u këqyren dhe u administruan kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, sipas parashikimeve në aktet ligjore dhe nënligjore.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm rezultoi se:

¹ Shkresë nr.K4/I75-2 prot., datë 15.12.2022 dërgohet “Rekomandim për inspektimin e kryer në Drejtorinë/komisariatit e Policisë Vlorë”.

1. Janë marrë masat pjesërisht për, ndërtimin sa më parë në Komisarriatin e Policisë Vlorë të ambientit të ri të dhomave të sigurisë, sipas kushteve e kriterëve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare, me qëllim shtimin e numrit të dhomave të sigurisë, rritjen e kapaciteteve akomoduese për të ndaluar/arrestuarit dhe përmirësimin e kushteve e trajtimin dinjitoz të këtyre personave. Në këto dhoma ishin kryer investime si dhe ishin krijuar dy dhoma sigurie të reja të cilat ishin sipas standardeve të përcaktuara.
2. Ishte realizuar rekomandimi mbi krijimin e dhomës së mjekut e cila ishte krijuar në ambientet e zyrave të administratës së komisarriatit për mungesë ambientesh në dhomat e sigurisë, për realizimin e vizitave mjekësore e cila është e kompletuar me pajisjet dhe me orenditë e nevojshme.
3. Ishin marrë masat, për respektimin e të drejtës së shtetasve të shoqëruar për tu informuar me të drejtat e tyre dhe dhënien e letrës me të drejtat e tyre që në momentin e hyrjes në mjediset e policisë, sipas rekomandimit të CPT-së për këtë qëllim.
4. Ishin marrë masat e nevojshme, për eliminimin e erës së mykut dhe sigurimin e një higjienë të pastër në dhomat e sigurisë, për ruajtjen e shëndetit të personave të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë, nga inspektimi u evidentua se nuk ishin realizuar disa nga rekomandimet e mëposhtme:

1. Të merren masa të menjëhershme, për përshtatjen e një dhome më vehte brenda sistemit të dhomave të sigurisë, për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar, e cila të jetë e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive.
2. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e një ambienti brenda sistemit të dhomave të sigurisë, i cili të shërbejë si vend i posaçëm ajrimi për të ndaluarit/arrestuarit.
3. Të merren masat për, instalimin e butonave/zileve në dhomat e sigurisë ekzistuese, për njoftimin e personelit të shërbimit në rast nevojë nga personat e ndaluar/arrestuar, nisur nga ngjarjet që kanë ndodhur në disa komisarriate policie (komisarriatet e policisë Kamëz dhe Kavajë në DVP Tiranë) gjatë vitit 2022 me pasojë vdekjen e personave.

Në përfundim të vizitës inspektuese, grupi i monitorimit të MKPT-së u takua edhe me Drejtorin e DVP-së Vlorë, z. Ermal Muçaj, me të cilin ndau dhe trajtoi disa nga gjetjet e grupit të inspektimit në komisarriatin e policisë Vlorë.

Vlen të theksojmë angazhimin e Drejtorit të DVP-së Vlorë, për bashkëpunimin dhe trajtimin me seriozitet dhe përgjegjësi lidhur me zbatimin e rekomandimeve, të institucionit të Avokatit të Popullit të cilat u evidentuan nga inspektimi i Avokatit të Popullit në këtë institucion.

Sipas informacionit në DVP Vlorë dhe nga komisarati i policisë, arsyeja e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit ka të bëjë me mungesën e fondeve të planifikuara për investime. Projekti për rikonstruksionin e godinave të Drejtorisë dhe Komisariatit të Policisë Vlorë, i cili përfshin edhe ndërtimin e bllokut të ri të sigurisë, është i miratuar nga DPPSH që në vitin 2019 dhe pritet të financohet nga buxheti i shtetit.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Vlorë ishte ndërtuar i ri dhe përmbushte përgjithësisht kriteret e përcaktuara në procedurën standarde të punës “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”².

Ky ambient ishte ndërtuar ngjitur me ambientin ku ndodhen dhomat e sigurisë të komisarariatit, në një nga godinat që ndodhen brenda territorit të DVP-së Vlorë.

Ambienti kishte 2 dhoma shoqërimi të ndara më vehte për të rriturit dhe për gratë. Përmasat e dhomave ishin 3x4 m², me hapësirë dhe sipërfaqe për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona të shoqëruar në secilën dhomë. Dhomat ishin të pajisura me stola me këmbë të fiksuara në dysheme, për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Ato ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno sanitare.

Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që mundësonin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Ato kishin edhe ndriçim artificial që furnizoheshin nga rrjeti elektrik. Dritaret ishin të siguruara me skarë hekuri, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga mjediset e komisarariatit.

Ndërkohë, në ambientet e DVP-së Vlorë ishte krijuar mjedis më vehte “*Njësia për mbrojtjen e grave viktime të dhunës në familje dhe kundër trafikimit të qënieve njerëzore*”, ambient i cili shërbente njëkohësisht edhe për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Ky mjedis përbëhej nga dy dhoma, një dhomë për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar gra dhe të mitur, si dhe një dhomë që përdorej për intervistimin e tyre nga punonjësit e policisë të trajnuar për këtë qëllim, në prezencë të kujdestarit ligjor, psikologut dhe avokatit mbrojtës për rastin e të miturve. Përmasat e dhomave ishin 4x3 m² dhe kapaciteti i tyre ishte për 5 persona.

Dhomat e intervistimit ishin funksionale dhe të kompletuara me orenditë e pajisjet e nevojshme për qëndrimin ulur dhe në kushte komode pune për punonjësit e policisë, gjatë procesit të marrjes në pyetje të grave dhe të miturve në konflikt me ligjin. Ato kishin sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme, si dhe dritare që mundësonin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Këto dhoma ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno sanitare.

² *Kreu i VII “Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar” pika 2, 3, 4 dhe 5 i procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”.*

DVP Vlorë në kuadër të “Njësisë për luftën kundër dhunës në familje dhe trafikimit të qënieve njerëzore”, kishte një bashkëpunim të mirë me Qendrën “Vatra”, e cila trajton dhe strehon gratë e vajzat, të evidentuara gjatë procesit të hetimit nga punonjësit e policisë ose janë të rrezikuara për trafikim, me qëllim ri-integrimit të tyre në shoqëri.

Dhomat e shoqërimit kishin ngjitur një tualet, i pajisur me nyje hidrosanitare dhe çezëm me rubinet. Tualeti kishte furnizim me ujë të rrjedhshëm.

Në mungesë të ambienteve të veçanta për intervistimin, marrja në pyetje e personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës së punonjësve të policisë. Lidhur me këtë gjetje Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me **“Rekomandimin për krijimin e ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria”**. Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës (MKPT), nisur nga kryerja e inspektimeve periodike në ambientet e privimit të lirisë së personit (dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie), si dhe nga trajtimi i një numri të konsiderueshëm të ankesave të shtetasve drejtuar institucionit tonë, ka konstatuar në një numër të shumtë rastesh se, nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, raste për të cilat janë të njohura përmes rekomandimeve përkatëse dërguar organeve të policisë në nivel vendor dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit. *Sa më sipër rekomandua:* Marrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme, për krijimin (ndërtimin) sa më parë brenda sistemit të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë të DVP/Komisariateve të policisë në të gjithë vendin, të dhomave më vehte për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/arrestuar/ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit, të plotësuara me orëditë e nevojshme dhe të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Marrjen e menjëhershme të masave, që në projektet për përmirësimet e reja infrastrukturore në komisariate të ndryshme, të parashikohet në të tëra rastet dhoma e intervistimit si në dhomat e shoqërimit, ashtu edhe në ato të sigurisë.

Nga inspektimi i dhomave të shoqërimit dhe zyrave të punës, nuk u konstatuan sende apo pajisje që të ekspozonin dhunë psikologjike ndaj personave të shoqëruar kur merreshin në pyetje prej tyre.

Korridori në ambientin e shoqërimit monitorohej me kamera, pamjet e të cilës mbikëqyreshin nga salla operative e DVP-së Vlorë. Pamjet filmike ruheshin deri në 15 ditë.

Në ambientet brenda dhe jashtë dhomave të shoqërimit, ishin të afishuara karta me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit.

Në momentin e inspektimit, nuk ndodhej asnjë person i shoqëruar në këto ambiente. Nga verifikimi i regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, për periudhën

Janar – Mars 2023, ishin shoqëruar në këto mjedise 194 persona, nga të cilët 17 gra dhe 18 të mitur.

Në mjediset e shoqërimit, grupi i inspektimit nuk konstatoi sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në Komisarriatin e Policisë Vlorë, ishte përgjithësisht i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Ky ambient ndodhej në katin e parë të një prej godinave brenda territorit të Komisarriatit të Policisë Vlorë. Ai përbëhej nga 6 (gjashtë) dhoma sigurie, të ndara në 4(katër) dhoma për persona e rritur, 1(një) dhomë për gratë dhe 1(një) dhomë për të mitur.

Dhomat ishin të plotësuara me shtretër dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe akomodimin e 10 personave. Por, nisur nga fakti se DVP Vlorë mbulon një qark të rëndësishëm nga pikëpamja e territorit dhe numrit të popullsisë, ka fluks të lartë të njerëzve që frekuentojnë këtë zonë gjatë gjithë vitit, si dhe faktit se në këto dhoma sigurohen persona të ndaluar dhe të arrestuar edhe nga punonjësit e komisarriatit të policisë Himarë dhe stacionet e policisë Orikum dhe Selenicë, **numri i dhomave të sigurisë ekzistuese dhe kapaciteti i tyre konsiderohet shumë i ulët.**

Në këto kushte, institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se është e domosdoshme rritja e numrit të dhomave të sigurisë dhe e kapaciteteve akomoduese në komisarriatin e policisë Vlorë, me qëllim garantimin e kushteve dhe trajtimin dinjitoz të personave të arrestuar apo të ndaluar.

Në momentin e inspektimit, u konstatua se në dhomat e sigurisë ndodheshin 5 persona të arrestuar, të gjithë në moshë të rritur. Nga verifikimi i regjistrit për personat e ndaluar/arrestuar që ndodhej në ambientin e sigurisë, rezultoi se, për periudhën Janar – Mars 2023 ishin evidentuar të dhënat për 65 persona të arrestuar/ndaluar, nga të cilët 1 grua. Gjithashtu, nga verifikimi i regjistrit në dhomat e sigurisë të këtij komisarriati, rezulton se nuk ka patur mbipopullim. Më tej, nga verifikimet e regjistrit, situata e popullimit në dhomat e sigurisë ishte e stabilizuar brenda kapacitetit zyrtar një përmirësim i respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria ndryshe nga një vit më pare.

Referuar normave dhe parametrave që duhet të plotësojnë dhomat e sigurisë, sipërfaqja dhe hapësira e dhomave të sigurisë në këtë komisarriat, ishte e mjaftueshme për të përballuar kapacitetin për 10 persona. Dhomat e sigurisë ishin të pastra nga ana higjieno sanitare, ato ishin të kompletuara me krevate dhe materiale për fjetje si dyshek, batanije dhe jastëk për 10(dhjetë) persona. Materialet e fjetjes për personat e ndaluar/arrestuar mbaheshin në një magazinë dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Dritaret e dhomave të sigurisë ishin me përmasa të vogla, ndaj nuk mundësonin ajrim dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm për shikim dhe lexim të ndaluar/arrestuarve. Pavarësisht mungesës të fondeve buxhetore për investime, nga ana e Drejtorisë dhe komisariatit të policisë Vlorë, duhet të mundësohet kryerja e investimit për zgjerimin e përmasave të dritareve të dhomave të sigurisë, pasi ato duhet të plotësojnë kushtin për lejimin e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, pa cenuar kushtet e sigurisë fizike.

Në dhomat e sigurisë kishte edhe ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje të energjisë elektrike, kishte gjenerator që shërbente si burim rezervë për furnizimin me energji elektrike.

Në ambientin e sigurisë ndodheshin pesë tualete, nga të cilat dy ishin brenda dhomave (dhoma për gra dhe dhoma për të mitur) dhe një tualet i përbashkët që ndodhej në korridor bashkë me ambientin e dushit. Këto ambiente ishin të kompletuara me pajisje hidrosanitare dhe çezma me rubinet, që furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm për 24 orë. Në ambientin e dushit kishte një bolier për ngrohjen e ujit, që shërbente për larjen e trupit të personave të arrestuar/të ndaluar.

Komisariati i Policisë Vlorë nuk kishte sistem qendror për ngrohje/ftohje. Sipas informacionit, ngrohja e ambienteve sigurohej me pajisje elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Veç dhomave të sigurisë, në korridorin e ambientit të sigurisë kishte 1(një) dhomë e cila kryente disa funksione si dhomë e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, dhomë për marrjen në pyetje/intervistimin e të ndaluarve/ arrestuarve nga OPGJ/prokurorët e çështjes, për takime me avokatët mbrojtës. Kjo dhomë kishte një krevat, një tavolinë pune, një karrige dhe disa rafta për mbajtjen e dokumentacionit. Dhoma shërbente njëkohësisht edhe si magazinë për mbajtjen e materialeve që i nevojiteshin përgjegjësit të dhomave të sigurisë për furnizimin e personave të ndaluar/arrestuar me materiale për qëndrim dhe jetesë normale.

Kjo dhomë, përtej funksioneve që kryente, konstatojmë se nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në procedurën standarde për ndërtimin e dhomave që ndodhen në ambientin e sigurisë.

Konkretisht, dhoma për zhvillimin e procesit të marrjes në pyetje dhe e kryerjes së veprimeve të tjera procedurale me të arrestuarit/ndaluarit, duhet të jetë dhomë e veçuar brenda sistemit të dhomave të sigurisë. Përmasat e kësaj dhome duhet të jenë jo më pak se 4m x 4m dhe orenditë që vendosen në këtë dhomë si tavolina pune e karrige për të qëndruar ulur e punuar përfaqësuesit e organit të akuzës (oficer i policisë gjyqësore apo prokurori), avokati mbrojtës/përfaqësuesi ligjor, si dhe i ndaluari/arrestuari, duhet të jenë të ndërtuara prej materiali druri dhe të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme e të pa çmontueshme lehtësisht³.

³Kreu VII, pika 7 e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".

Në korridorin e ambientit të sigurisë ishte i instaluar një telefon fiks, i cili shërbente në rastet urgjente për njoftimin e zyrës së informacionit nga punonjësit e policisë që shërbenin në këtë ambient. Ndërsa, brenda në dhomat e sigurisë ishin vendosur buton me zile/sinjali në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevoje.

Në pjesën e jashtme dhe në korridorin e ambientit të sigurisë, kishte të instaluara kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti.

Sipas informacionit të mbledhur, në rastet kur personat e ndaluar/arrestuar ishin shtetas të huaj, zbatohet menjëherë procedura për njoftimin e përfaqësive diplomatike të vendeve të tyre, si dhe pajiseshin me kartën e të drejtave në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë. Pajisja me avokat mbrojtës dhe përkthyes në gjuhën e tyre, është një detyrim ligjor dhe duhet të plotësohet domosdoshmërisht. Referimet e rasteve pranë avokatëve mbrojtës dhe përkthyesve, kryhen nga specialistët e policisë (opgj) që marrin në pyetje këta shtetas, duke marrë për bazë listat e miratuara të avokatëve dhe përkthyesve, që disponohen prej tyre. Në përgjithësi, avokati mbrojtës dhe përkthyesi sigurohen nga familjarët dhe të njohurit e këtyre personave.

Në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë ndodhej karta e të drejtave të shtetasve të privuar nga liria, e përkthyer në 10 gjuhë të huaja më kryesore.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisaratin e Policisë Vlorë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1”, konform procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Të gjithë personat e shoqëruar, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, ai ishte i plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por jo më shumë se 10 orë në raste të veçanta.

Në rastet kur akti/veprimi i shoqërimit kryhet nga oficeri/agjenti i policisë gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit është jo më tepër se 12 orë.

Në zyrën e informacionit të Komisarariatit, ishte hapur një regjistër më vehte për evidentimin e të dhënave të personave të mitur, në bazë dhe rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim⁴. Për vitin 2023 ishin evidentuar të dhënat për 18 persona të mitur.

⁴ Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 “Për garantimin e të drejtave të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisariati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Grupi i inspektimit verifikoi regjistrat ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisariateve të policisë në varësi të DVP Vlorë dhe konstatoi se, zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës së viteve të kaluara lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës nga oficeri i policisë gjyqësore.

Në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë, ndodheshin të gjithë regjistrat dhe librat e shërbimit që parashikohen në procedurën standarde si:

- regjistri i evidentimit të personave të arrestuar/ndaluar;
- regjistri marrjes në pyetje nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore;
- regjistri i takimeve të të arrestuarve/ndaluarve me mbrojtësit ligjorë (avokatë e kujdestarë), mbrojtësit e të drejtave të njeriut (OJQ e OJF), Avokatin e Popullit etj.;
- regjistri i kërkesë/ankesave të personave të privuar nga liria;
- regjistri i evidentimit të vizitave mjekësore që kryhen menjëherë pas arrestimit/ndalimit, gjatë kohës së qëndrimit të dhomat e sigurisë, në qendrat spitalore;
- libri i marrjes, dorëzimit të shërbimit të sigurisë së brendshme dhe sigurisë së jashtme të dhomave të sigurisë;
- fashikulli për administrimin e kopjeve të deklaratës për njohjen e të drejtave nga të arrestuarit/ndaluarit, me nënshkrimin e tyre;
- lista e punonjësve të policisë që shërbejnë në dhomat e sigurisë dhe lista e personelit ndihmës teknik që lejohet të hyjnë në dhomat e sigurisë, të miratuara nga drejtori i policisë së vendore/shefi i komisarariatit të policisë;
- libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit për sigurimin e të arrestuarve/ndaluarve në qendrat spitalore;
- regjistri i takimit të nënës me fëmijën për ushqyerjen me gji;
- regjistri takimeve të personave të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, me pjesëtarë të familjes;
- regjistri i sendeve personale të arrestuarve/ndaluarve, etj.

Të gjithë librat e shërbimit e regjistrat ishin të regjistruar me numër fletësh në sekretari dhe të vulosur, dhe pas përfundimit të tyre ato dorëzoheshin po në sekretarinë e institucionit, për t'u ruajtur sipas afateve të përcaktuara për to.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarariatit e Policisë Vlorë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar, ndërsa në dhomat e sigurisë ndodheshin 5 (pesë) persona në cilësinë e të arrestuarve.

Grupi i inspektimit intervistoi personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë. Nga intervistimi rezultoi se ata ishin të pajisur me setin e dokumenteve që duhet të mbahet prej tyre si kopje të urdhër ndalim/arrestimit, procesverbali për dorëzimin e sendeve personale, si dhe letra me të drejtat e këtyre personave.

Personat e arrestuar nuk paraqitën asnjë ankesë për keqtrajtime nga punonjësit e policisë gjatë procesit të marrjes në pyetje, si dhe punonjësit e shërbimit në ambientin e sigurisë.

Nga verifikimi i librit të ankesave dhe kërkesave, u evidentua se nuk kishte asnjë ankesë apo pretendim për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike nga punonjësit e policisë.

Nga intervistimi i të arrestuarve dhe informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që kryenin shërbim në dhomat e sigurisë rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë, ndërsa të miturit deri në katër vakte, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë. Ushqimi shërbehej me katering nga një subjekt privat, në bazë të kontratës së lidhur midis DVP Vlorë dhe këtij subjekti.

Personat e arrestuar apo të ndaluar, për ditët që qëndronin në ambientin e sigurisë, gëzonin të drejtën për të kryer ritet fetare sipas besimeve të tyre, për të lexuar libra, si dhe për të shkruar. Sipas sistemit të ndërtimit, në dhomat e sigurisë në Komisaratin e Policisë në Vlorë mungonte dhoma e ajrimit, ku personat e ndaluar/të arrestuar mund të kalojnë deri 2 orë në ditë, sikurse është e përcaktuar në procedurën standarde⁵, duke sjellë si pasojë cënimin e një të drejte ligjore për këta persona.

Gjithashtu, nga intervistat me personat e arrestuar që ndodheshin në momentin e inspektimit, u evidentua ishin furnizuar me detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, si kusht për mbajtjen pastër të higjienës personale, ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Ambientet e intervistimit

Nga inspektimi i ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, rezultoi se mungonte dhoma e marrjes në pyetje/intervistimit më vehte, si për personat e shoqëruar dhe për personat e ndaluar/arrestuar, kur ata ndodhen për arsye shoqërimi apo si të dyshuar për vepra penale, në mjediset e këtij komisarati.

Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të kalonin nga ambienti i shoqërimit për në ambientin e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk plotësonin kushtet dhe kriteret e nevojshme, pasi ato duhet të jenë

⁵ *Kreu VII, pika 6 e procedurës standarde thuhet shprehimisht se: "Ajrimi kryhet në mjediset të caktuara brenda sistemit të ambienteve të dhomave të sigurisë, në një vend të ndërtuar posaçërisht (dhomat e ajrimit)..... Koha e qëndrimit në ajrim është jo më pak se dy orë në ditë."*

të pajisura me orenditë e nevojshme dhe të monitoruara nga sistemi i kamerave audio-vizive.

Avokati i Popullit, bazuar në standardet ndërkombëtare e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre⁶.

Gjatë inspektimit u vizituan zyrat e punonjësve të policisë, që kryenin veprime procedurale me shtetasit e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar dhe nuk u gjetën pajisje prania e të cilave ekspozon dhunë tek personat në kohën e intervistimit të tyre.

Në lidhje me investimin e parashikuar që në vitin 2019 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për rikonstruksionin e godinave të Drejtorisë dhe Komisarariatit të Policisë Vlorë, grupi i inspektimit konstatoi se dhe për këtë vit buxhetor, ende nuk ishin planifikuar fondet për zbatimin e këtij projekti. Deri në fillim të zbatimit të këtij projekti, DVP Vlorë duhet të marrë masa për krijimin (përshtatjen) e dhomave të veçanta për intervistimin apo marrjen në pyetje të shtetasve, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në hyrje të ambientit të shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë, ishin afishuar posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar. Grupi i inspektimit kërkoi informacion në lidhje me mënyrën e informimit të personave të shoqëruar me të drejtat e tyre. Nga informacioni rezultoi se, të shoqëruarit pajiseshin me kartën e të drejtave që në momentin e hyrjes në mjediset e policisë, një standard ky i plotësuar nga rekomandimet e Avokatit të Popullit.

E drejta për informim është një e drejtë themelore e shtetasve. Kjo e drejtë duhet të respektohet me rigorozitet edhe për personat e privuar nga liria në mjediset e policisë së shtetit. Nisur nga kjo e drejtë kushtetuese dhe e njohur me aktet ndërkombëtare, KPT (CPT) në vizitën e tij inspektuese në Shqipëri në vitin 2018, ka rekomanduar autoriteteve shtetërore *“Sigurohuni që personat e arrestuar/arrestuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të ndalimit ose arrestimit. Personave të arrestuar/ndaluar duhet t’u jepet dhe të*

⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

*nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se kanë marrë një kopje të fletës me të drejtat e tyre*⁷.

Rekomandimi i KPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, **duhet tu jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit**, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Kjo, pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 10 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kohore ata merren në pyetje nga specialistët e policisë apo kanë të drejtë për njoftimin e familjarëve të tyre, e drejta për qasje me avokat mbrojtës, etj.

Ndërkohë, personat e ndaluar apo të arrestuar pajiseshin me setin e dokumenteve (urdhri për ndalimin/arrestimin në flagrancë të personit, procesverbali i dorëzimit të sendeve personale), midis tyre dhe letrën e të drejtave, nga oficeri i policisë gjyqësore, në momentin e komunikimit të masës së arrestit dhe kalimin e tyre për në dhomat e sigurisë.

Sipas informacionit dhe intervistave me të ndaluarit/arrestuarit, punonjësit e policisë u bënë të ditur personave të ndaluar/arrestuar, të drejtën dhe detyrimin për tu mbrojtur me avokat mbrojtës gjatë procesit të marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

Të ndaluarit/arrestuarit që kërkonin mbrojtjen me avokat u ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me avokatët mbrojtës në bazë të listës së afishuar në ambientin e sigurisë. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit, nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht të caktuar nga prokurori i çështjes, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, ose të zgjedhur nga familjarët e tyre, si dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Takimet me avokatët mbrojtës, kryheshin në dhomën e improvizuar në ambientin e sigurisë, sa herë që kërkoheshin nga personat e ndaluar/arrestuar.

Vizita mjekësore me personat e ndaluar/arrestuar dhe ofrimi i ndihmës mjekësore, të parashikuara në procedurat standarde, kryhej rregullisht nga mjeku në dhomën e tij të vizitave. Mjeku ishte në organikë të DVP Vlorë⁸ dhe i punësuar me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet për vizitë te mjeku specialist dhe mjekimet, regjistroheshin në librin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë të këtij komisariati. Në rastet e urgjencave, kur kërkoheshin ndërhyrje e mjekëve të specializuar, personat e sëmurë shoqëroheshin menjëherë për në Spitalin Rajonal Vlorë.

Sipas informacionit, vizitat mjekësore nga mjeku i DVP Vlorë, kryheshin dhe për personat e shoqëruar sa herë kërkoheshin nga ana e tyre, por në rast nevojë ata dërgoheshin edhe në Spitalin Rajonal të Vlorës.

⁷<https://rm.coe.int/16809cb571>.

⁸ *Kreu V, pika 7/2 e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".*

Në ambientin e sigurisë, ishte e afishuar lista e personave të miratuar që kanë të drejtë të hyjnë në këtë ambient, lista e avokatëve mbrojtës, si dhe ishte afishuar numri i kontakti me zyrën e Avokatit të Popullit.

Gjithashtu në këtë komisariat ishte hapur regjistri i kërkesë/ankesave të personave të arrestuar/ndaluar, por nga verifikimi i regjistrit, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë (për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë) nga personat e shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar.

Në këtë komisariat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika 1/f të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”:

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin sa më parë në Komisarlatin e Policisë Vlorë të ambientit të ri të dhomave të sigurisë, sipas kushteve e kriterëve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare, me qëllim shtimin e numrit të dhomave të sigurisë, rritjen e kapaciteteve akomoduese për të ndaluar/arrestuarit dhe përmirësimin e kushteve e trajtimin dinjitoz të këtyre personave.
2. Marrjen e masave për përshtatjen e një dhome më vehte brenda sistemit të dhomave të sigurisë, për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar, e cila të jetë e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive.
4. Marrjen e masave për, instalimin e butonave/zileve në dhomat e sigurisë ekzistuese, për njoftimin e personelit të shërbimit në rast nevojë nga personat e ndaluar/arrestuar, nisur nga ngjarjet që kanë ndodhur në disa komisariate policie (komisaritet e policisë Kamëz dhe Kavajë në DVP Tiranë) gjatë vitit 2022 me pasojë vdekjen e personave.
5. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti brenda sistemit të dhomave të sigurisë, i cili të shërbejë si vend i posaçëm ajrimi për të ndaluarit/arrestuarit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI